AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 2953/1 Prot.
Datë,më 25 / 10 /2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE"STILIANO BANDILLI"
BERAT

Nr. 296 Prot.

Berat më 23 / 09 /2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar :

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 " Për nxitjen e Punësimit „ Ligjit Nr.15/2017"Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Urdhëzimit nr 14, datë 27.05.2021." Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve publikë të arsimit dhe të formimit professional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore.", Kreu XXI, Neni 109 "Shpallja e vendit të lire për personel mësimdhënës të kulturës profesionale me kohë të plotë"

Shkolla e mesme profesionale " Stiliano Bandilli", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin"Mësimdhënës i praktikës profesionale"dega"Termohidraulikë",(me kohë të plotë).

1. **Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
b) të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
e) të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
f) të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Alikanti duhet të plotesojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të paktën nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional (dega Termohidraulikë)
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet
c) të njohë, të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë,duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin
b) jetëshkrimin(CV)
c) kartën e identitetit
d) diplomën
e) librezën e punës
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
h) vërtetimin e gjendjes shëndetsore
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimt dorëzohen në protokollin e shkollës , brenda datës 13.10.2023.
(jo më pak se 5 ditë pune dhe jo më shumë se 15 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

Drejtor i shkollës

Ing . Kozeta Nushi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"STILIANO BANDILLI"
BERAT